



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
RAPORTI VJETOR 2025

Shkurt, 2025

PËRMBAJTJA

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2.	KORNIZA LIGJORE.....	5
2.1	Baza ekzistuese ligjore.....	5
2.2	Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	6
2.3	Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet	6
3.	PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	7
3.1	Misioni i OSHP-së.....	7
3.2	Kompetencat sipas ligjit.....	8
3.3	Metodologjia	9
4.	FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI.....	11
4.1	Bordi dhe administrata.....	11
4.2	Burimet njerëzore	12
4.1	Administrata.....	13
4.2	Trajnimet.....	14
4.3	Asetet	15
5.	AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE.....	15
5.1	Paraqitje e të dhenave të ankesave për raportim.	15
5.1	Masat ligjore ndaj Operatorve ekonomik dhe Autoriteteve kontraktuese.....	31
5.1.1	Vendimet për kërkesat për diskualifikim të Operatorve Ekonomik	31
5.2	Vendimet e gjykatave	33
5.3	Marrëdhënia me publikun	33
5.4	Donatorët	34
5.5	Bashkëpunimi i jashtëm	34
6.	SFIDAT.....	35
7.	RAPORTI FINANCIAR	37
8.	RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT	37
9.	SHTOJCAT	38

OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
LPP	Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
LPPA	Ligji për procedurën e përgjithshme administrative
BE	Bashkimi Evropian
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
AK	Autoritetet kontraktuese
OE	Operatorët ekonomik
DT	Dosja e Tenderit
ST	Specifikimet Teknike
AP	Aktiviteti i Prokurimit
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
USAID	U.S. Agency for International Development
SIGMA	Nismë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
MB	Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar

Raporti vjetor, i referohet periudhës kohore të vitit 2025 dhe i njëjti paraqet një pasqyrim të aktiviteteve të realizuara, sikurse kërkohet në mënyrë specifike me paragrafin 1, të nenit 121 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP) sipas të cilit shprehimisht parashihet se *“Për çdo vit kalendarik, OSHP do t’i sigurojë Kuvendit, më së voni deri në fund të shkurtit të vitit pasues kalendarik, informacionet dhe të dhënat në vijim, sipas llojeve të procedurave dhe objekteve të aktivitetit përkatës të prokurimit”*.

OSHP gjatë vitit 2025 ka nxjerrë 1350 vendime për ankesat e dorëzuara nga operatorët ekonomik gjatë vitit 2025, si dhe për një pjesë të ankesave të vitit 2024, për të cilat vendimet janë nxjerrë gjatë fillimit të vitit 2025. Në vitin 2025 janë pranuar 1292 ankesa.

Ligji i Prokurimit Publik(LPP), në nenin 111 parag. 3 dhe 4, nenin 114, nenin 115 parag.1 , ka caktuar afate ligjore procedurale të trajtimit ankesës për; vlerësimin pranueshmërisë ankesës, për plotësimin e ankesës, hartimi aktekspertizës nga eksperti shqyrtues,deklarimi i palëve për aktekspertizen dhe këto afate procedurale janë 19 dite dhe nuk mund te themelohet panel shqyrtues, pa u konsumuar afatet procedurale. Sipas nenit 117, paragrafi 1, LPP, afati ligjor i Panelit shqyrtues (PSH) per marrjen e vendimit, është 15 ditë dhe për raste të ndërlikuara plus 20 ditë, në total janë 54 dite afate ligjore.

OSHP për vitin 2025 afatin e marrjes vendimit e ka zbritur në 50 ditë dhe kemi nje permisim pozitiv, në raport me vitin 2024 ku afati mesatar i marrjes se vendimit ishte 56 ditë, ulje per 6 ditë.

Panelet shqyrtuese pas themelimit,sipas neneit 117 , 1.të LPP-së afati mesatar i marrjes se vendimeve meritore në vitin 2025 ishte 24 ditë.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1 Baza ekzistuese ligjore

Legjislacioni primar

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 18/2011, data, 19.09.2011, e që në fakt ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar disa herë si në vijim:

- Ligji Nr. 04/L-237 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 25/2014, data, 17.04.2014;
- Ligji Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 01/2016, data, 06.01.2016;
- Ligji Nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.8/2016, data, 01.03.2016.

Dhe

Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat, i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 26/2011, data, 25.11.2011.

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e radhitura si më sipër konsiderohen pjesë integrale e Ligjit Nr. 04/L-042 në versionin e tij të amendamentuar, por, legjislacioni aktual, pritet sërish t'i nënshtrohet ndryshimeve, meqë Ministria e Financave ka hartuar-publikuar Draft ligjin e ri të prokurimit publik, në vitin 2024 dhe pritet të procedohet për miratim në organin kompetent sipas dispozitave ligjore.

Legjislacioni sekondar

Konsiston në të gjitha aktet nënligjore të bazuara në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të nxjerra/miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Organi i Shqyrtimit Publik, të cilat mes tjerash përfshijnë:

- Rregulloren për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Nr. 83/20, e datës 03.03.2020 dhe
- Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 002/2024, e datës 11.11.2024, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, e datës 20.10.2022.
- Udhëzues Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, i datës 01.02.2023 dhe

2.2 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Ligji i Prokurimit Publik i Republikës së Kosovës është në procedurë të ndryshimit për të cilën Organi Shqyrtues i Prokurimit është i gatshëm të jap kontributin e tij profesional në grupet punuese. OSHP ka iniciuar procesin e plotësim-ndryshimit të Rregullores së Punës së OSHP-së që të harmonizohet me legjislacionin aktual. Rregullorja pritet të aprovohet gjatë vitit 2025 pas konsultimit publik me të gjithë akterët relevant.

2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet

Organi Shqyrtues i Prokurimi, ka pasur vështirësi në përmbushjen e misionit për faktin se ligji aktual i LPP-së ka zbraztësirat ligjore të cilat nuk ka mundur mjaftueshëm t'i definojë Rregullorja e Prokurimit Publik, andaj OSHP konsideron si çështje të rëndësishme plotësim-ndryshimin e ligjit, të cilat kanë vështirësuar punën e OSHP-së në ushtrimin e mandatit të tij ligjor.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 Misioni i OSHP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, është një nga institucionet qendrore të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitën e nenit 65, lidhur me dispozitën e nenit 142, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe i cili në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, ushtron juridiksion ekskluziv lidhur me zgjidhjen e të gjitha çështjeve kontestuese për aktivitetet e prokurimit publik, të iniciuara nga të gjithë autoritetet kontraktuese (në nivelin qendror dhe lokal) dhe operatorët ekonomik ankues nga ana tjetër, përfshirë ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të cilat konsiderohen si të nevojshme dhe të arsyeshme, bazuar në diskrecion dhe pavarësinë e garantuar institucionale, në procesin e vlerësimit dhe të vendosjes meritore.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, ushtron pavarësinë e plotë institucionale në zbatimin e mandatit të tij ligjor në harmoni me nenin 98, ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat e parashikuara dhe/ose të renditura taksativisht me dispozitën e nenit 99, lidhur me nenin 103 dhe 105, në harmoni me parimet bazë të prokurimit publik të sanksionuara në Kreun II, lidhur me nenin 104 dhe drejtohet në të gjitha pikëpamjet në ushtrimin e funksioneve parësore të tij/saj (në vend dhe jashtë) nga Kryetari i OSHP dhe Bordi i këtij institucioni, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në harmoni me nenin 100 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

OSHP ka misionin në përputhje me objektivat si:

- a) Përmbushja e *qëllimeve bazë* të LPP, të cilat në kuptim të nenit 1 të LPP, konsistojnë në:
 - Sigurimin e shfrytëzimit efikas dhe të drejtë të fondeve publike nga ana e AK;
 - Sigurimin e përgjegjësisë dhe integritetit në procesin e prokurimit publik;
 - Sigurimin e barazisë dhe mos diskriminimit, ekonomizimit dhe transparencës;
 - Promovimin e një kulture institucionale dhe profesionale;
- b) Ngritja e *kapaciteteve profesionale* të OSHP, të cilat janë më se të domosdoshme për:
 - Përmbushjen e qëllimeve bazë të legjislacionit vendor, të shpjeguara si më sipër;
 - Përgatitjen e OSHP, proceset e Integritetit Evropian, të cilat në kontekstin e prokurimit publik, parashihen shprehimisht me dispozitën e nenit 79 të Marrëveshjes për Stabilizim Asocimin (MSA).

Neni 79 (Prokurimi Publik) i MSA përmban 9 paragrafë të cilët shprehimisht parashohin detyra për autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës, siç thuhet, cituar “*për zbatim të rregullave të prokurimit të BE*” (paragrafi 2). Në kontekstin e këtyre zhvillimeve, OSHP angazhohet mes tjerash dhe në përmirësimin e punës profesionale, i cili ushtron funksionet më sfiduese në sistemin e prokurimit publik.

OSHP konsideron se realizimi i objektivave të mësipërme, është e nevojshme për të realizuar misionin e OSHP-së dhe për ta pasqyruar atë në raportim para Kuvendit të Republikës së Kosovës. OSHP është i obliguar që Kuvendin rregullisht ta vë në dijeni, lidhur me të gjitha informacionet e kërkuara me dispozitat e neneve 120 dhe 121, të LPP, përfshirë të arriturat dhe sfidat, objektivat dhe planifikimet për të ardhmen.

3.2 Kompetencat sipas ligjit

Sipas nenit 98 të LPP, OSHP është një nga organet e administratës qendrore të Republikës së Kosovës dhe i pavarur në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi, të cilat janë përkufizuar me nenin 99 të këtij Ligji sipas të cilit, OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji. Në këtë rast, në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij gjatë procesit të vendimmarrjes, OSHP e ushtron autoritetin e vendimmarrjes në nivel të paneleve shqyrtuese, në përbërje nga 1/një, 3/tre ose 5/pesë anëtarë, sipas nenit 106 të LPP lidhur me nenin 17, 21 të Rregullores për Punën e OSHP, varësisht nga vlera e kontratës, natyra komplekse dhe rëndësia e çështjes.

Panelet Shqyrtuese udhëhiqen apriori nga parimet bazë, të sanksionuara mes tjerash me dispozitën e nenit 104, sipas të cilit të gjitha palët do të kenë qasje të barabartë në procedurat e shqyrtimit dhe në përdorimin e mjetit juridik dhe se asnjë vendim nuk do të merret me pasoja të pabarazisë, diskriminimit në të mirë ose dëm të një subjekti. Në mënyrë specifike, kompetencat e OSHP janë të radhitura në mënyrë taksative në dispozitën e nenit 105 të LPP, sipas të cilit Panelet Shqyrtuese kanë përgjegjësi që t'i shqyrtojnë të gjitha shkeljet e mundshme të këtij ligji, duke i adresuar detyrimet për ndërmarrjen e veprimeve si në vijim:

(a) Secili anëtar i Panelit Shqyrtues është i detyruar që, në varësi të shkallës dhe natyrës së shkeljeve të pretenduara nga operatorët ekonomik:

- të analizojë të dhëna, dokumente, të mbajë seancat e shqyrtimit publik dhe të japë dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues në ushtrimin e arsyeshem në diskrecion të tij, e konsideron relevante për të verifikuar pretendimet e palëve;

(b) Secili Panel Shqyrtues është i detyruar që, në varësi të shkallës dhe natyrës së shkeljeve:

- t'i jep urdhër AK që ta pezullojë ose përfundojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose vendimit të tij/saj. Si dhe, të anulojë ose revokojë vendimin e tij/saj i marr si pasojë e specifikave dhe/ose kushteve të paligjshme të vendosura në dosjen e tenderit, i cili konsiderohet një nga dokumentet kyçe në aktivitetin e prokurimit dhe t'i evitojë shkeljet dhe/ose të parandalojë dëmtimin eventual të ndonjë pale të interesuar;

(c) Secili Panel Shqyrtues është i detyruar që, në varësi të shkallës dhe natyrës së shkeljeve:

- të lëshojë një urdhër i cili e shndërron një kontratë të nënshkruar në infektive, nëse janë vërtetuar shkelje të nenit 42 dhe nenit 26 të këtij ligji dhe t'i imponojë gjoba, nëse autoriteti kontraktues, në varësi të shkeljeve dhe vlerësimit të pavarur të tij/saj;

OSHP vlerëson se secili AK ushtron autonominë institucionale në planifikimin e nevojave dhe përmbushjen e tyre, të cilat i garantohen me dispozitat e nenit 8 dhe 9 dhe ka të drejtë ta përpilojë Dosjen e Tenderit (DT) në kuptim të nenit 27 të LPP, sipas të cilit, *cituar*: “autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj... çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes...”. Në kuptim të kësaj dispozite, DT përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i saj supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, me synim që të sigurojë mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike dhe të promovojë integritetin e prokurimit publik.

OSHP angazhohet në mënyrë konstante për trajtimin e të gjitha ankesave të parashtruara nga OE në mënyrë sa më profesionale dhe meritore. Në të gjitha rastet, secili Paneli Shqyrtues synon që vendimet të bazohen në administrimin e të gjitha provave në dispozicion të një lënde duke pasur gjithmonë parasysh qëllimin e LPP i sanksionuar në nenin 1, sipas të cilit ku sigurohet mënyra më efikase, transparente dhe më e drejtë e shfrytëzimit të fondeve publike, të promovojë përgjegjësinë, profesionalizmin dhe kulturën institucionale në fushën e prokurimit publik.

3.3 Metodologjia

Raporti vjetor, përbëhet nga informatat bazë, të nevojshme për informimin e rregullt të Komisionit Parlamentar për Punë, Buxhet dhe Transfere të Kuvendit të Kosovës, të cilat si të tilla rezultojnë nga konteksti i nenit 121 të LPP-së. Raporti përmban një prezantim dhe përshkrim më preciz të të dhënave të cituara, të përmbledhura dhe të shoqëruara me shpjegimet e nevojshme përkitazi me gjendjen paraprake, mandatin dhe ndryshimet. Kurse, niveli i të dhënave dhe kualiteti i tyre burojnë nga arkivi dhe dokumentacioni në dispozicion të OSHP. Raporti përmban edhe materiale statistikore, duke ju përmbajtur formatit të raporteve të rregullta vjetore për nga struktura e tyre institucionale dhe përfshinjë edhe disa nga format e mundshme vizuale, tabelare dhe grafike të paraqitjes së të dhënave, të bashkëngjitura si anekse.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka disa databaza ku informacionet regjistrohen, mblidhen, përpunohen në kohë reale, në mënyrë që institucioni të ketë një pasqyrë në kohë reale rreth performancës së OSHP-së. Për përgatitjen e këtij raporti janë shfrytëzuar të dhënat nga e-Prokurimi, ueb faqja e OSHP-së, Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve, Databazën e Brendshme të OSHP-së dhe Tabela e evidentimit të vendimeve të ankimuar në gjykatë, duke përfshirë ankesat, kërkesat për diskualifikim dhe vendimet e marra nga OSHP.

OSHP ka përdorur metodën krahasimore për të krahasuar të dhënat me dy vitet e fundit, për të krahasuar performancën me dy vitet e kaluara.

Duke i pasur për bazë orientimet parimore nga aspekti metodologjik, raporti përmban por nuk kufizohet në të dhënat si në vijim:

- Numri i lëndëve, respektivisht ankesave të dorëzuara nga operatorët ekonomik, brenda vitit kalendarik 2025, të cilat parashtrohen në OSHP, në kuptim të nenit 109 të LPP-së;
- Numri i vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, të cilat veprojnë nga cilësia e tyre si kolegje profesionale përkitazi me vendosjen meritore, në kuptim të nenit 105 të LPP-së;
- Numri i ankesave të pazgjidhura;
- Vlera e tarifave të konfiskuara/kthyera;
- Shpenzimi i buxhetit sipas raportit financiar;
- Diskualifikimet;
- Gjobat e shqiptuara;
- Numri i padive në gjykatën kompetente;

Fushëveprimi i OSHP-së është i përcaktuar me LPP, Rregulloren e Punës së OSHP-së dhe Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës së OSHP-së.

OSHP sipas LPP-së ka mandatin të shqyrtojë të gjitha ankesat e paraqitura në OSHP lidhur me shfrytëzimin e fondeve publike nga ana e AK:

- Ankesat e OE sipas LPP dhe Ligjit për Partneritet Publiko-Privat
- Kërkesat për diskualifikim të OE të dorëzuara nga AK
- Ankesat për ankament publike


4.1 Bordi dhe administrata

Bordi i OSHP, përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Aktualisht Bordi i OSHP-së funksionon me vetëm katër(4) anëtar, pasi një anëtar është dorëhequr më 15.08.2024.

Në bazë të nenit 102 të LPP, Kryetari përfaqëson, drejton, organizon dhe është përgjegjës për ushtrimin e rregullt të funksioneve dhe mbikëqyrjen e administrimit të përditshëm të veprimtarisë së OSHP, që do të thotë se të gjitha kompetencat me ekzekutiv dhe vendimmarrës në kontekstin si më sipër (me përjashtim të rasteve, kur ai/ajo është anëtar e panelit), i takojnë Kryetarit të OSHP.

Përderisa, në kuptim të nenit 98 të LPP, sekretaria, respektivisht administrata, ushtron në mënyrë të rregullt funksione në mbështetje për Kryetarin dhe Bordin.

Shtojca Nr. 2 – Organogrami i OSHP-së



4.2 Burimet njerëzore

Pozitat	Kategoria	Legjislacioni
1	Kryetari/ja	Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
2	Bordi i OSHP	
3	Sekretariati	Ligjit për Zyrtarët Publik
4	Administrata	

Pozita	Numri	Koeficienti	
1	Kryesues i Sekretariatit	1	13.10
2	Udhëheqës i Divizionit për Pranimin e Ankesave	1	8.40
3	Udhëheqës i Divizionit të Brendshëm	1	8.40
4	Ekspert Shqyrtues	10	6.75
5	Udhëheqës i Divizionit për çështje juridike	1	8.40
6	Zyrtarë të Lartë Ligjor	4	6.75

7	Zyrtar Kryesor për Financa	1	8.40
8	Menaxhere e Personelit	1	8.40
9	Zyrtar për Pranimin e Ankesave	1	6.75
10	Zyrtar për të Hyra Financiare	1	6.75
11	Përkthyes (anglisht - shqip dhe anasjelltas)	1	6.75
12	Asistent ekzekutiv (të Paneleve Shqyrtuese)	1	6.20
13	Asistente Administrative	1	6.20
14	Drejtues automjeti	1	4.88
15	Udhëheqës i Divizionit të TI	1	7.4
16	Specialist i TI	1	6.2
	Gjithsej	35	/

4.1 Administrata

Në këtë vit raportues OSHP i ka pasur 35 pozita pune ndërsa i ka pasur 25 të punësuar dhe gjatë këtij viti raportues është rekrutuar edhe një puntorë i Teknologjise Informative i cili ka filluar me punë në janar 2026. Pozitat e lira të vendit të punës janë shpallur tetë (8) procedura të rekrutimit për pozitat si në vijim:

1. Udhëheqës i Divizionit për Çështje Juridike një (1) pozitë, ka rezultuar e suksesshme;
2. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, një (1) pozitë, ku është pezulluar procedura sipas vendimit të KPMSHCK-së;
3. Zyrtar për Mbështetjen e Paneleve Shqyrtuese, një (1) pozitë, ka rezultuar e suksesshme;
4. Zyrtar për Arkiv, një (1) pozitë, ka rezultuar e suksesshme;
5. Zyrtar i Lart i Teknologjisë Informative një (1) pozitë, ka rezultuar e suksesshme;
6. Ekspert Shqyrtues dy (2) pozita, konkurs është anuluar pasi që nuk kemi pasur kandidat të suksesshëm;
7. Ekspert Shqyrtues dy (2) pozita ka rezultuar me një kandidatë të suksesshëm, por jemi në pritje të afatit të ankesave.
8. Zyrtar i Lart Ligjor një (1) pozitë, konkurs është anuluar pasi që nuk kemi pasur kandidat të suksesshëm;

Për pozitat e lira sipas konkursit publik, katër (4) procedura kanë rezultuar të jenë të suksesshme, një procedur për dy (2) Eksperta Shqyrtues është anuluar pasi që nuk ka pasur kandidat të suksesshëm ndërsa një (1)procedurë tjetër për një Ekspert Shqyrtues, është ankimuar vendimi Komisionit rekrutimit të OSHP-se për perzgjedhjen e kandidatve dhe jemi në pritje të vendimit nga KPMSHC dhe një (1) procedure rekrutimi për pozitën: Zyrtar i lart ligjor është anuluar procedura e rekrutimit pasi që nuk kemi pasur kandidatë të suksesshëm.

4.2 Trajnimet

Gjatë vitit 2025 stafi i OSHP-së ka marrë pjesë në këto trajnime dhe punëtori:

Data	Vendi	Qëllimi	Përshkrimi
Maj-Korrik 2025	Prishtinë - Kosovë	Trajnim	Programi themelore profesional per prokurim publik
23-25 Maj 2025	Durrës - Shqipëri	Workshop	Hartimi i draft rregullorës për komunikim me publikun
24 Prill 2025	Prishtine-Sigma/OECD	Konferencë	Fuqizimi i Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë.
Korrik 2025	Ankara - Turqi	Workshop	The Journey of Digitalisation
6 Nëntor 2025	Prishtinë Democracy Plus	Punëtori	Plani i Performances se OSHP-së ,për vitin 2026
13-16 Nëntor 2025	Durrës - Shqipëri	Trajnim	Procedurat e shqyrtimit administrativ dhe administrimi i punëve ne zyrë
11 Nëntor 2025	Prishtinë"Hotel Sirius" Autoriteti i Konkurences	Konferenca	Dita e Konkurrencës 2025
20 Nëntor 2025	Prishtinë "Hotel Emerald" Sigma/OECD	Konferencë	Forrcimi i Koordinimit dhe Integritetit në Prokurim Publik.
1-2 Dhjetor 2025	Zagreb-Kroaci	Workshop	Takimi i rrjetit të organeve të shqyrtimit të prokurimit publik në Evropën juglindore

4.1 Asetet

Institucioni i OSHP-së është në rrugën “Migjeni”, në objektin e ish-Bankës së Lubjanës, kati V dhe një pjesë e katit të IV. Kjo hapësirë nuk është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, sepse OSHP ka një numër të madh të lëndëve si kopje fizike, të cilat kanë nevojë të arkivohen dhe hapësira aktuale është e pamjaftueshme. Po ashtu, ka nevojë edhe për hapësirë shtesë për stafin që planifikohet të punësohet në të ardhmen. Gjithashtu, hapësira aktuale nuk është e përshtatshme për kushtet e punës, objekti është i vjetër, i pa rinovuar dhe pa ngrohje.

Për më tepër lidhur me asetet e OSHP-së i gjeni në raportin financiar më detajisht.

5. AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE

5.1 *Paraqitje e të dhënave të ankesave për raportim.*

Duke ju referuar nenit 120 të LPP (Raportimi në Kuvend) parashihet se, OSHP do t’i raportojë çdo vit Kuvendit mbi mbarëvajtjen e procedurave të përcaktuara të shqyrtimit të prokurimit. Kurse sipas dispozitës së nenit 121 të Ligjit të cituar (Dërgimi i informacioneve), parashihet se OSHP do t’i sigurojë Kuvendit, informacionet dhe të dhënat, siç thuhet, cituar: *sipas llojeve të procedurave dhe objekteve të aktivitetit përkatës të prokurimit (të cilat janë precizuar në paragrafin 1, nën-paragrafët nga 1.1. - 1.6.) dhe për nevojat e këtij Raporti, përshkruhen si në vijim:*

1. Numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar, të zgjidhura dhe në shqyrtim;
2. Numri i ankesave të palejuara (si të pasafatshme dhe të pakompletuara), sipas nenit 109, 111 ose 118;
3. Numri i ankesave që janë konstatuar se nuk / apo mbajnë pretendime të vlefshme;
4. Numri i aktiviteteve të prokurimit të cilat janë anuluar me vendim të OSHP-së;
5. Informata të detajuara mbi çdo ngjarje ku autoriteti kontraktues ka dështuar në respektimin e një urdhërese të OSHP-së;
6. Numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme;

- *Shqyrtim paraprak i ankesave sipas ligjit.*

Ankesat e ushtruara nga subjektet të cilët kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 i LPP, të cilat janë ushtruar brenda afatit ligjor sipas paragrafit 2, të nenit 109 dhe konsiderohen të kompletuara sikurse kërkohet me nenin 111 lidhur me nenin 118 të LPP, bien nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP-së.

Bazuar në shpjegimet e cituara shkurtimisht si më sipër, ankesat e ushtruara në këtë rast i janë nënshtruar fazave të mëtejme të shqyrtimit administrativ, respektivisht shqyrtimit preliminar nga ekspertët shqyrtues, sikurse kërkohet me dispozitat e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, dhe vendimeve meritore të paneleve shqyrtuese. Përderisa, ankesat të cilat nuk kanë qenë të kompletuara, sikurse kërkohet kjo shprehimisht me dispozitat e cituara si më sipër, janë hedhur si ankesa të palejuara.

OSHP sipas mandatit të dhënë nga LPP nxjerrë disa lloje të vendimeve:

- Vendimet për shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik.
- Vendimet për kërkesa për diskualifikim nga autoritetet kontraktuese për operatorët ekonomik.
- Vendimet për shqyrtimin për ankesat e operatorëve ekonomik lidhur me ankandet publike.

- *Afatet ligjore për marrjen e vendimeve*

Ligji i Prokurimit Publik, ka përcaktuar afatet procedurale ligjore të trajtimit të ankeseve në stadi të caktuara me afate të veqanta dhe po ashtu ka caktuar afatin ligjor të vendimmarrjes nga ana e paneleve shqyrtuese si në vijim;

- Ligji i Prokurimit Publik, në nenin 111 paragrafi 3, ka caktuar një afat prej **1 ditëve** për vlerësimin pranueshmërisë të ankesës, pas pranimit të saj.

- Ligji i Prokurimit Publik, në nenin 111 paragrafi 4, ka caktuar një afat prej **4 ditëve** Operatorit ekonomik për plotësimin e ankesës së paraqitur në OSHP.

-Ligji i Prokurimit Publik, në nenin 114 ka përcaktuar një afat prej **10 ditëve** për ekspertin shqyrtues për vlerësimin e pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

-Ligji i prokurimit Publik, në nenin 115 paragrafi 1 ka përcaktuar një afat prej **4 ditëve** për Autoritetin Kontraktues dhe Operatorin Ekonomik, për tu deklaruar se a pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues.

Ligji ka përcaktuar në total gjithsej nënëmbdhjetë (**19 ditë**) afate procedurale të ankesës dhe në këtë fazë mund të nxjerrën vetëm vendime procedurale dhe nuk mund të nxjerrën vendime meritore. Vetëm pas kalimit të afatit procedural ligjor mund të caktohen panelet shqyrtuese për marrjen e vendimeve meritore në afate sipas ligjit si në vijim;

-Ligji i Prokurimit Publik në neni 117, paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar një afat prej **15 ditëve** për OSHP/PSH për nxjerrjen e një vendimi meritor lidhur me ankesën.

Po ashtu sipas këtij neni OSHP/PSH për çështjet e ndërlikuara të ankesave e ka edhe një afat shtesë ligjor për vendimmarrje prej **20 ditëve**.

Nga dispozitata ligjore të lartëcitura shihet se ligji ka caktuar se afati ligjor në total për vendimamrrije është pesëdhjet e katër (54) ditë nga dita e paraqitjes së ankesave në OSHP.

- *Numri i ankesave të paraqitura në OSHP*

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik në vitin 2025, ka pranuar gjithsej 1.292 ankesa të paraqitura nga operatorët ekonomik kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese, i ka vendosur 1.142 ankesa dhe kanë mbetur pa u vendosur 150 ankesa. Prej tyre 100 ankesa nuk kanë mund të vendosen pasi nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vendimamrrije Ligji i Prokurimit Publik, në nenin 111 paragraf 3 dhe 4, nenin 114, nenin 115 paragraf 1 nuk ka mund të caktohet panel shqyrtues, ndërsa vetëm për 50 ankesa janë caktuar panelet shqyrtuese sipas nenit 117, paragrafi 1, i Ligjit i Prokurimit Publik, por nuk ka arritur të nxjerr vendime për shkak të ngarkesave me lëndë.

Gjatë vitit raportues 2025 OSHP ka marrë 1350 vendime, ku përfshihen 1142 vendime për ankesat e vitit 2025 dhe 208 vendime për ankesat e mbetura në vitin 2024.

Kjo tregon performancë të OSHP gjatë vitit 2025 ka nxjerrë më shumë vendime se që ka pranuar ankesa, dhe në këtë mënyrë ka ulur numrin e rasteve aktive në shqyrtim.

Në tabelën 1 janë paraqitur të gjitha llojet e vendimve të cilat nxirren nga OSHP sa i përket ankesave të operatorëve ekonomik dhe baza ligjore dhe komente se çka nënkupton vendimi i cekur në tabelë.

	Lloji i vendimit	Dispozitat ¹	Koment
1	Vërtetimi i vendimit të AK	105/2.7	OSHP ka lënë në fuqi vendimin e AK
2	Rivlerësimi	105/2.8.	Vlerësimi i gabuar i ofertave
3	Anulimi	105/2.7.	Vendim për anulimin e AP
4	Urdhëresa	105/2.7.	OSHP ka lëshuar urdhëresa
5	Përmirësimi	105/2.8.	Parregullsi në DT
6	Kontrata shfuqizohet	130	Kur OSHP pranon ankesë pasi që kontrata është nënshkruar
7	Kontrata mbetet në fuqi	130	Kur OSHP pranon ankesë pasi që kontrata është nënshkruar
8	Të refuzuara si të palejuara	109; 111	Në rastet e cilësuar si të palejuara
9	Të pasafatshme	109	Ka humbur afatin tek AK apo OSHP
10	Të refuzuara si të parregullta	111	Mungesë e pagesës së tarifës, e tjerë


¹ Dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

11	Tërheqja e ankesës	1032-283	OE kanë tërhequr ankesën
12	Përfundon shqyrtimi administrativ		
13	Pezullohet shqyrtimi nga vendimi i gjykatës		
14	Pajtimi i palëve	108/A;115	Zakonisht pajtimi i palëve ndodh pas vlerësimit preliminar të ankesës, nga eksperti shqyrtues.

² LPPA [Neni 103]

³ Rregullorja e Punës së OSHP [neni 28]


Në grafikun nr. 1 janë paraqitur numri i ankesave të dorëzuara në tri vitet e fundit, dhe numri i vendimeve të nxjerra për ato ankesa gjatë tri viteve, pa llogaritur ankesat e dorëzuara në vitin paraprak të cilat janë zgjidhur në vitin vijues.



Grafiku 1 - Krahasimi i ankesave të pranuar dhe të zgjidhura për vitet 2023-2025.

Sqarim: Nga 150 ankesat "në shqyrtim" ne vitin 2025, për 100 ankesa nuk ka pas panele shqyrtuese, pasi nuk janë plotësuar kushtet ligjore- LPP, neni 111 parag. 3 dhe 4, neni 114,115 porg.1, ndërsa për 50 ankesa, ka pasur panele shqyrtuese por kanë mbetur të pavendosura.


Në grafikun 2 janë paraqitur të dhëna se sa aktivitete të prokurimit kanë ankesa në OSHP. Kjo e dhënë tregon se numri i aktiviteteve të prokurimit është më i vogël se numri i ankesave dhe kjo si rezultat që për disa aktivitete të prokurimit ka më shumë së një ankesë.



Grafiku 2 - Numri i aktiviteteve të prokurimit dhe ankesave për vitet 2023-2025.

Ndërsa grafiku nr. 3 paraqet numrin e vendimeve të nxjerra gjatë një viti kalendarik e ku në to përfshihen edhe ankesat e dorëzuara në vitet paraprake.


Siç shihet OSHP në vitin 2025 ka pasur përmirësim të performancës ku ka arritur që të nxjerrë më shumë vendime se që ka pranuar ankesa gjatë këtij viti, e në të njëjtën kohë ka zvogëluar numrin e lëndëve në shqyrtim.



Grafiku 3 - Krahasimi mes numrit të ankesave dhe numrit të vendimeve për 2024-2025.

Në grafikun nr. 4 janë paraqitur të dhëna për vendimet e nxjerra gjatë vitit 2025 që janë brenda dhe jashtë afatit ligjor sipas LPP-së.


Numri i vendimeve jashtë afatit ligjor ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të ankesave, Bordi i OSHP ka qenë i pakompletuar gjatë vitit 2025, që ka bërë që një pjesë e vendimeve të mos mund të nxirren brenda afatit ligjor.



Grafiku 4 - Vendimet e nxjerra brenda dhe jashtë afatit ligjor për vitin 2025.


